



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____2019

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____

PËR
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË SUBJEKTIN
"POSTA SHQIPTARE" SHA TIRANË

për periudhën nga data 1.07.2017 deri më 31.05.2019

Nga auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në subjektin "Posta Shqiptare" SHA, mbështetur në trajtimet e hollësishme në Raportin përfundimtar të Auditimit, rezultoi se pavarësisht përpjekjeve pozitive të Drejtuesve, sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga shoqëria nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjithashtu si drejtimi edhe stafi ekzekutiv nuk kanë njohje të plotë të legjislacionit në fuqi. Ky legjislacion njihet përgjithësisht, por jo i integruar apo i analizuar. Mos njohja si duhet e legjislacionit ka çuar në shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit dhe për këtë është rekomanduar marrja e masave përmirësuese.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë" të ushtruar në subjektin "Posta Shqiptare" SHA, sipas programit të auditimit nr. 391/1 Prot., datë 03.06.2019, për veprimtarinë nga data 01.07.2017 deri më 31.05.2019, me afat auditimi nga data 6.06.2019 deri në datën 31.07.2019

II. Të miratoj opinionin e Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik **ISSAI 4000**¹.

Përgjegjësitë e audituesve

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, bazuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Ndër përgjegjësitë kryesore është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së postës, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të shoqërisë është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

Shoqëria ka si qëllim sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, të sigurt, të shpejtë dhe me kosto konkurruese, rritjen në cilësi dhe në lloje të shërbimeve, monitorimin e shërbimeve për shmangien risqeve dhe abuzimeve gjatë shërbimeve.

Theksim të çështjeve të bazës së opinionit

Mbështetur në punën audituese si dhe gjetjet nga auditimi grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se si drejtimi ashtu dhe stafi ekzekutiv nuk ka njohje të plotë të legjislacionit në fuqi. Ky legjislacion njihet përgjithësisht por jo i integruar apo i analizuar. Mos njohja si duhet e legjislacionit ka çuar në shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit ku devijimet e konstatuara nuk janë materiale. Për sa më sipër Opinioni ynë është i kualifikuar dhe bazohet në çështjet e theksuara më poshtë.

-Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mospërputhje të veprimtarisë me aktet ligjore ku konkretisht:

-Nga shoqëria, referuar realizimit të treguesve ekonomik për tre vite, ka rezultuar se investimet janë planifikuar tej mundësive reale të menaxhimit të fondeve. Ky realizim paraqitet në nivele shumë të ultë, që tregon për planifikime optimiste dhe të paargumentuara të tyre.

-Dëmet ekonomike të konstatuara janë në **vlerën 6,969,270 lekë** të cilat kanë ardhur si pasojë e keq menaxhimit në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave.

¹ISSAI 4000 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

-Efekte negative financiare **në vlerën 145,698,753 lekë** të cilat kanë ardhur si pasojë e mos zbatimit dhe interpretimit jo korrekt të legjislacionit në fuqi si dhe mos argumentimit të nevojës për publicitetin dhe marketingun e shërbimeve të Postës Shqiptare sha.

-Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga shoqëria nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësimit të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësimit dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, etj.

GJETJET DHE REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programeve ekonomike të Postës Shqiptare SHA, rezultoi se investimet, nga burimet e veta kanë qenë programuar gjithsej 268.4 milion lekë në 2017 dhe 343.9 milionë lekë në vitin 2018 kundrejt një realizimi prej 194.7 milion lekë në 2016. Referuar realizimeve për të dy vitet ka rezultuar se nga shoqëria janë planifikuar investime jashtë mundësive reale të menaxhimit të fondeve të investimeve, pasi si për vitin 2017 dhe 2018 niveli i realizimit të investimeve ka qenë respektivisht i ulët në masën 47.9 % në vitin 2017 dhe 67.1 % në vitin 2018. Për vitin 2019 programi i investimeve paraqitet i programuar dhe miratuar në shumën 847.6 milion lekë dhe ku realizimi 6 muajor paraqitet pa vlera, në një kohë që totali i të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjitha vitet sa më sipër paraqitet afërsisht i barabartë, gjë që tregon që shoqëria programon tej mundësive financiare dhe kapaciteteve reale të menaxhimit të procedurave të prokurimit dhe realizimit të fondeve për investime.

Gjithashtu nga auditimi në filialin Posta Shqiptare Shkodër referuar kërkesave për programin e vitit 2019 të këtij filiali, si dhe çeljes së fondeve për të, dërguar me shkresën nr.248, datë 28.01.2019 të Postës Shqiptare sha, nuk rezulton një balancim midis të ardhurave dhe shpenzimeve, ku të ardhurat e programuara paraqiten me një nivel 73 % më i lartë nga niveli i shpenzimeve të programuara, sipas detajimit apo çeljes së bërë nga Drejtoria Posta Shqiptare sha. Gjithashtu theksojmë se rritja e nivelit të programuar të realizimit të të ardhurave me 12 % kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2018 nga drejtoria, në kushtet ku në filialin e Shkodrës si dhe zyrat postare të sajë ka mungesë të kushteve të punës, materialeve, si dhe infrastrukturës së domosdoshme, e kthejnë planifikimin në objektiva të pa mundshme për tu realizuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 12-18 të Raportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të ndiqen politika të kujdesshme në lidhje me përcaktimin e objektivave të sajë, të cilat duhet të jenë në përputhje mundësitë menaxhuese e financiare dhe gjithnjë në përcaktimin e investimeve ku në program të përfshihen investimet prioritare dhe të mundshme për tu realizuar.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë gjatë procesit të vendosjes së objektivave të shoqërisë referuar objektivave të vendosura për realizimin e të ardhurave të filialeve, duhet të shoqërojë këtë proces me një plan veprimi dhe argumentin mbështetës të rritjes së tyre, ku domosdoshmërisht duhet të mbështetet dhe me krijimin e kushteve të punës dhe infrastrukturës së domosdoshme.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të pagesave të bankës për periudhën objekt auditimi janë konstatuar pagesa për dieta për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare, referuar programeve të miratuar nga Titullari i AK. Referuar këtyre programeve rezulton se kryhen procedura kontrolli pas fakti, funksione këto të strukturës së Auditimit të

Brendshëm. Megjithëse këto kontrolle janë realizuar nga punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme, nuk ka raporte apo informacione mbi rezultatet e kontrollit dhe marrja e masave për përmirësimin e situatës, detyrime këto të cilat nuk janë parashikuar në programet përkatëse të miratuara. Veprimtaritë e kontrolleve të kryera nga strukturat përkatëse (kryesisht Departamenti i Administrimit dhe Departamenti i Shërbimeve) nëpërmjet programeve të miratuara nga titullari, bien në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 22 pika 5 për “ Veprimtaritë e kontrollit”.Theksojmë se përcaktimet në rregulloren e brendshme të funksioneve të kontrolleve dhe monitorimit, referuar interpretimit të ligjit, realizohen me veprimtaritë e përcaktuara në nenin neni 22 “ veprimtaritë e kontrollit”, nenin 23 “Informimi dhe komunikimi”, dhe neni 24 “ monitorimi” për kontrollet para faktit dhe jo pas fakti (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 77-81 të Raportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Sa më sipër nga Nëpunësi Autorizues të ndërpriten praktikat e miratimeve të kontrolleve pas faktit nga drejtoritë e Postës Shqiptare për detyra funksionale të cilat duhet të kryhen nga struktura e auditimit të brendshëm.

Për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe veprimtaritë e kontrollit, referuar përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit, nga menaxherët të zbatohen procedurat e përcaktuara në Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Posta Shqiptare SHA, arkëtimet e realizuara për “pagesat e detyrimeve doganore, të akcizës, dhe detyrime të tjera të pagueshme në dogane” referuar marrëveshjes ndërmjet Postes Shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme së Doganave (DPD) mbi shërbimin e arkëtimit në favor të DPD i ka derdhur me vonesë.

Derdhjet me vonesë bien në kundërshtim marrëveshjen e lidhur mes palëve me nr. Prot. të Postës Shqiptare nr.4522, datë 15.12.2014 neni 2 pika 4 “Detyrimet e Postës” ku citohet se arkëtimet duhet që të derdhen maksimumi ditën e nesërme ora 10.00.”

Detyrimi i Postës më 31 Dhjetor 2018 është në shumën 29,522,813 lekë sipas deklarimit të DPD, kundrejt 29,544,699 lekë të Postës Shqiptare, i pa rakorduar. Ky detyrim në fund të vitit 2017 ka qenë në shumën 62,861,303 lekë. Pavarësisht likuidimit më shumë se detyrimet e vitit dhe zvogëlimit të borxhit, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Financiar dhe Bankar ashtu dhe nga Drejtoria Ekonomike nuk është zbatuar likuidimi sipas parashikimit në marrëveshje, që arkëtimet duhet të derdhen brenda ditës së nesërme deri në orën 10. Kjo marrëveshje është ndryshuar gjatë vitit 2019 duke e vendosur si kusht detyrimin për likuidim të arkëtimit të realizuara të çdo dite nga Posta Shqiptare, brenda 48 orëve dhe kushtit të aplikimit të kamat vonesave për rastet e tejkalimeve të këtyre afateve.

Gjatë auditimit të bankës ky fenomen rezultoi gjatë gjithë periudhës, dhe ku në fund të vitit Posta Shqiptare sha, ka rezultuar me detyrime ndaj të tretëve për arkëtimet e realizuara dhe të pa derdhura, referuar marrëveshjeve që ka në fuqi për këto shërbime me institucionet përkatëse.

Referuar informacionit të marrë nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Bankare, në Postën Shqiptare sha kryhen shërbime financiare (arkëtime të faturave të energjisë elektrike, të ujësjellësve, të detyrimeve doganore nga bizneset, detyrimet doganore për blerjet online, arkëtimet e taksave të bashkive, pagesat për gjoba, dëshmi penaliteti, legalizimet, pagesat për çerdhet e kopshtet, tarifrat shkollore, arkëtimet për ZVRPP, për arkivin e shtetit, kryhen pagesat e ndihmës ekonomike e paaftësisë së përkohshme, kryhen pagesat e pensioneve, rimbursimi i librit shkollor) si dhe shërbime bankare ku kryen veprime për llogari të 4 institucioneve bankare si F. B, P B,S G B dhe IC A sha për arkëtimin e kësteve të kredive të dhëna nga to ku për të cilat nuk ka konfirmim mes palëve për arkëtimet e realizuara dhe të pa derdhura për efekt rakordimi në fund viti.

Për vitin 2019 u konstatua se me shkresën e datës 15.04.2019 nga Drejtoria e Shërbimeve Bankare dhe Financiare urdhërohet derdhja e shumave të arkëtuara për doganën në vlerën 6,545,962 lekë. Nga dokumentacioni i bankës u konstatua se likuidimi është kryer me datë 14.05.2019 për arkëtimet e datave 12-14 Prill 2019 që do të thotë është kryer me vonesë gjë e cila sjell penalitete kundrejt Postës Shqiptare, bazuar në marrëveshjen me nr. 995 prot., datë 09.04.2019 neni 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-90 të Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Sa më sipër nga Drejtoria e Shërbimeve Bankare dhe Financiare si dhe nga Drejtoria Ekonomike të kryhen derdhjet e arkëtimeve për shërbimet që kryen Posta Shqiptare referuar marrëveshjeve, duke respektuar me rigorozitet afatet e vendosura në to.

3.2.Rekomandim: Për efekt të rakordimit të shumave të fund vitit dhe pasqyrimin të drejtë dhe të besueshëm në kontabilitet, të lihen gjurmë konfirmimi nga palët nëpërmjet rakordimit ndërmjet Posta Shqiptare dhe institucionit me të cilën është lidhur marrëveshja, për shumat arkëtim i padredhur në fund viti. Ky rregull të jetë efektiv dhe për arkëtimet e filialeve të cilat kryejnë direkt derdhjen e arkëtimeve të realizuara.

3.3Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Bankare dhe Financiare e shoqërisë Posta Shqiptare SH.A, të marrë masat e nevojshme për zbatimin me përpikmëri të marrëveshjes së nënshkruar nr. 995 prot., datë 09.04.2019 me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në mënyre shmangien e penaliteteve.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Posta Shqiptare sha kryhen pagesa për telefoninë celulare për punonjësit referuar faturave sipas paketave të lidhura për çdo numër të Albtelekom Albania sha referuar kontratës së lidhur, ku për një pjesë të tyre bëhet rimbursimi nga fondet e Postës Shqiptare sha.

Rimbursimi i fondeve për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar në zbatim të vendimeve të drejtorisë së shoqërisë nr.293, datë 25.04.2014 “Mbi ndryshimin e shpenzimeve të telefonisë celulare të Shoqërisë Posta Shqiptare sha, vendimit nr.44, datë 7.02.2017 “Mbi disa ndryshime në vendimin nr.293, datë 25.04.2014 të Drejtorisë së Shoqërisë, si dhe Urdhrin e dalë për periudhën objekt auditimi me nr.193, datë 19.03.2018“Për miratimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për ndryshimet e miratuara në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare sha”.

Për vendimet sa më sipër u krye krahasimi referuar përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 23.07.2010“Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”.

Nga ky krahasim ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi janë lejuar kryerja e shpenzimeve në kundërshtim me aktin në fuqi respektivisht sipas viteve: për 6 mujorin e dytë të 2017 shuma prej 571,560 lekë, për vitin 2018 shuma 1,256,400 lekë dhe për 5 mujorin e vitit 2019 shuma prej 1,318,560 lekë **në total 3,146,520 lekë**(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-81 të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Nga ana e Postës Shqiptare të shfuqizohen vendimet e drejtorisë për ato kategori që janë jashtë limiteve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave sa më sipër cituam.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në CB me datën 13.12.2018 është kryer likuidimi pjesor i faturës nr. 25 datë 04.12.2018 të subjektit A shpk në shumën 1,500,000 lekë, ku vlera e faturës ka qenë në shumën 2,880,000 lekë. Bashkëlidhur nuk ka dokumentacion tjetër dhe nuk ka shënime se në cilën pagesë gjendet dokumentacioni përkatës. Në C B me datën 13.12.2018 është kryer likuidimi pjesor i faturës nr. 14 datë 26.10.2018 të subjektit S shpk në shumën 2,300,000 lekë, fatura në shumën 5,413,680 lekë. Bashkëlidhur nuk ka dokumentacion tjetër justifikues dhe nuk ka shënime se në cilën pagesë

gjendet dokumentacioni përkatës. Nga auditimi rezultoi se këto ishin pagesa pjesore dhe dokumentacioni i plote vendosej tek pagesa e pare apo e fundit e likuidimit të faturës. Aktualisht në likuidimet sa me sipër nuk jepej informacioni i nevojshëm për likuidimin e kryer. Për efekt të transparencës dhe auditimit si dhe dhënien e informacionit për ndjekje të shpenzimit bashkëlidhur çdo likuidimi është i domosdoshëm të jepet informacioni shoqërues (në dokumentin e likuidimit apo faturën e likuiduar shënime, për kontratën apo informacione të tjera të rëndësishme) kjo referuar kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 “Evidenca mbështetëse” (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-81 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike për efekt të kontrollit dhe transparencës së veprimeve nëpërmjet bankës të merren masa që bashkëlidhur shpenzimit apo arkëtimit të vihet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm apo informacioni që argumenton veprimin bankar.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Urdhër shpenzimi për udhëtimet jashtë vendit të punonjësve, në të gjitha rastet firmoset nga nëpunësi udhëtues dhe nëpunësi autorizues, në një kohë që duhej të konfirmohej dhe nga nëpunësi zbatues i cili kryen kontrollin pas faktin, në zbatim të detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligjin për nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar. Gjithashtu dhe formati i miratuar dhe bashkëlidhur udhëzimit nr.22 datë 10.7.2013 të dalë në zbatim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 kërkon domosdoshmëri firmën e N/Z.

Gjithashtu u konstatua se për udhëtimet jashtë vendit jepen për punonjësit paradhënie, të cilat nga auditimi, kanë rezultuar të mbyllen me vonesë duke e tejkaluar shpesh herë periudhën një mujore por dhe duke tejkaluar vitin ushtrimor. U konstatuan gjithashtu raste të dhënies së paradhënies pa u mbyllur paradhënia e mëparshme për udhëtimet e realizuara, veprime që bien në kundërshtim me pikën 66 të udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Në Postën Shqiptare sha nuk kishte rregulla të përcaktuara në zbatim të akteve në fuqi në lidhje me udhëtimet jashtë e brenda vendit për afatet e dorëzimit të dokumentacionit, dokumentacionit ligjor të shpenzimit (ku theksojmë se faturat e hoteleve për efekt të zbatimit të udhëzimit, duhet të përmbajnë yjet si dhe konfirmimin e hotelit, etj.), si dhe formatin e detyruar për tu plotësuar bashkëlidhur udhëzimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-81 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues i Posta Shqiptare sha, të nxirren e miratohen rregulla të brendshme në lidhje me zbatimin në kohë të procedurave të shlyerjes të shpenzimeve për dieta brenda e jashtë vendit, konform dokumentacionit ligjor që kërkojnë aktet në fuqi. Urdhër shpenzimi si për dietat brenda e jashtë vendit duhet të jetë i konfirmuar dhe nga nëpunësi zbatues referuar kontrolleve pas faktit, konform kërkesave ligjore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dokumenti i fletëhyrjes së mallrave në magazinë i cili vendosej dhe në praktikën e likuidimit, paraqitet dokument fletëhyrje tatimore ku përmbante të gjithë të dhënat që kishte fatura, në një kohë që duhej të ishte një dokument që duhet të përmbante vetëm sasi të çmimit dhe vlerën e regjistrimit të mallit në magazinë. Pavarësisht korrektesisë së regjistrimit në librin e magazinës me vlerën pa TVSH apo me TVSH në rastet kur parashikonte ligji, referuar rasteve të audituara, mbajtja e fletëhyrjes tatimore me të gjithë të dhënat e faturës humbet gjurmën se me çfarë vlere është regjistruar malli. Të dhënat e fletë hyrjes duhet të përputhet me të dhënat që regjistrohen në kartelën e mallit. Nga Posta Shqiptare nuk u dha asnjë shpjegim përse mbahej një dokument i tillë në shumicën e rasteve ku në të gjitha filialet nuk mbahej një dokument i tillë. Veprimet sa më sipër bien në kundërshtim me rregullat e kontabilitetit të parashikuara në ligjin për

kontabilitetin e aktet e dala në zbatim të tij, bie në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar pika 37, 58, si dhe pika 53 që tregon çfarë informacioni tjetër duhet të përmbajë fletë hyrja dhe që është element kontrolli nga nëpunësi zbatues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-81 të Raportit të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të unifikohet dokumenti i fletë hyrjes në magazinë për të gjithë shoqërinë si dhe të mbahet në konsideratë dhe të përdoret dokumenti i duhur për fletë hyrjet e mallrave në magazinë, ku plotësimi i tyre të tregojë domosdoshmërisht sasinë çmimit e mallit dhe vlerën e fletë hyrjes me të cilin është bere regjistrimi në kartelën apo librin e magazinës.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sponsorizimeve rezultoi se në shumicën e rasteve kontratat e lidhura nuk kishin afatin e vlefshmërisë së kryerjes së aktivitetit (në një kohë që në kontratë jepej klauzola e të drejtës së marrjes së paradhënies prej 60% të shumës së sponsorizuar) si dhe në kontratë mungojnë gjithashtu zërat e preventivit që merrte përsipër sponsorizuesi të financonte (kjo kërkesë rezultoi nga fakti se objekti kërkues i sponsorizimit ishte i sponsorizuar dhe nga shoqëri të tjera dhe ku gjithashtu Posta Shqiptare jo gjithnjë sponsorizonte shumën e kërkuar).

Gjithashtu nga sponsorizuesi Posta Shqiptare sha për vitin 2019 për shumën e sponsorizuar deri më datën 7.06.2019 është tejkaluar përqindja e njohur sipas ligjit të sponsorizimit për njohje të tij si shpenzim i zbritshëm për efekt të përcaktimit të tatimit fitimit tatimor, referuar nenit 5 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “ Për sponsorizimet” i ndryshuar ku duhet të jetë deri në 3 % të fitimit tatimor. Fitimi tatimor i planifikuar për vitin 2019 është në shumën 25,000,000 lekë dhe sasia 3 % është e barazvlefshme me shumën prej 750,000 lekë, duke ndikuar kështu negativisht në rezultatin e shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 90-94 të Raportit të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Juridike e Postës Shqiptare në bashkëpunim me Drejtorinë e Marketingut për efekt të monitorimit ligjor dhe disponimit të dokumentacionit të justifikimit të shumave të sponsorizuara (detyrim i ligjit), të merren masa që kontratat e sponsorizimeve të kenë zërat e preventivit të aktivitetit që sponsorizohet si dhe të vendosen në kontratë afatet e vlerësimit të kryerjes së aktivitetit referuar kërkesës.

Menjëherë

8.2. Rekomandimi: Nga Administratori dhe Drejtoria e Marketingut të ndiqen politika të kujdeshme në lidhje me dhënien e shumave për sponsorizim, duke respektuar përqindjet e përcaktuara në ligj për shpenzime të njohura për efekt tatimor, me qëllim shmangien e ndikimit negativ në treguesit ekonomik të shoqërisë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se: **a.** Për vitin 2017 Posta Shqiptare me shkresën nr.2414/1 datë 30.07.2018 ka përcjell në Ministri të Financave dhe Ekonomisë Bilancin Kontabël dhe rezultati i tij me propozimin e shpërndarjes. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në pozicionin e aksionarit me shkresën nr.14476/1 datë 20.08.2018 (e protokolluar tek Posta Shqiptare sha me datën 2581, datë 23.08.2018) është miratuar bilanci kontabël dhe shpërndarja e rezultatit të vitit 2017. Sa më sipër për vitin 2017 Posta Shqiptare sha ka qenë në kushtet e tejkalimit të afateve të përcaktuara në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 33.

b. Nga auditimi i kryer deri në datën 26.07.2019 grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion pasqyrat financiare të aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme, pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë Posta Shqiptare SHA si dhe Raporti i ekspertëve të pavarur, me argumentimin e mos përfundimit të këtij misioni, pavarësisht se ka kaluar afati 45 ditë i lidhjes së kontratës dhe i dorëzimit të të dhënave fillestare. Për sa më sipër nga Drejtoria

Ekonomike nuk u dhanë shpjegimet për arsyet e moskryerjes së detyrimeve të mësipërme dhe fakti i qenies në kushtet e tejkalimit të afateve ligjorë. Fenomeni i dorëzimit jashtë afateve kohorë ka rezultuar dhe në dorëzimin e Pasqyrave Financiare të Filialeve për vitin 2017, ku në 11 raste nga 16 pasqyra financiare kanë rezultuar të dorëzuara pas datës 31 Mars 2018 për vitin 2017, ku ka rezultuar dhe mos konfirmimi i tyre nga nëpunësit autorizues të filialeve dhe mos shoqërimi i pasqyrave financiare me relacionin përkatës.

c-Gjithashtu shoqëria Posta Shqiptare sha gjatë periudhës objekt auditimi ka rezultuar se nuk ka të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës norma amortizimi dhe ku nga ana e saj janë aplikuar normat në kufijtë ligjorë të amortizimit të miratuara në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 22. Miratimi i normave të amortizimit me vendimmarrje të Këshillit Mbikëqyrës është i domosdoshëm për përcaktimin e politikës kontabël të shoqërisë dhe vazhdimësisë së saj dhe argumentohet me aktet dhe standardet në fuqi si :Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, i përmirësuar, pika 103, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr.5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 39.

d-Për nxjerrjet jashtë përdorimi për vitin 2016 dhe 2017 është konstatuar se procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit kanë rezultuar me afate kohore të përzgatura me mbi një vit duke kapërcyer dhe kohën e kryerjes së inventarizimit dhe procedimit për rezultatet e vitit koherent gjatë të cilit janë kryer veprimet, duke rënë ndesh me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ .

Për vitin 2018 pavarësisht se ka përfunduar inventarizimi i aktiveve të Shoqërisë edhe në filiale nga Drejtoria e Ekonomisë deri në momentin e këtij auditimi nuk është përgatitur materiali përmbledhës për Titullarin e institucionit për situatën e aktiveve të shoqërisë për vitin 2018, duke ngarkuar në këtë mënyrë me përgjegjësi këtë drejtori, referuar përgjegjësi të përcaktuara në ligjin për MFK dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, të ndryshuar.

f-Për procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarit të vitit 2017 në vlerën 11,743,229.7 lekë për Drejtorinë e Përgjithshme, nga Posta Shqiptare nuk ka njoftim për organet tatimore në zbatim të nenit 21 pika m të ligjit nr.8438, datë 28.12.2003 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 i ndryshuar pika 3.6.s., duke krijuar riskun që për vitin 2018 kur janë kryer veprimet e nxjerrjes nga përdorimi dhe kontabiliteti, këto shpenzime të mos njihen si shpenzime për efekte tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 100-113 të Raportit të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga Administratori dhe Drejtoria e Ekonomike të merren masa duke përcaktuar rregulla të brendshme me afate kohore konform akteve në fuqi, për dorëzimin brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, të pasqyrave financiare të filialeve, tranzitit dhe aparatit të Drejtorisë, duke përcaktuar dhe dokumentacionin dhe evidencat bashkëlidhur pasqyrave financiare, të domosdoshme për saktësinë edhe vërtetësinë e plotësisimit të rubrikave përkatëse të bilancit kontabël. Afatet kohore dhe përgjegjësitë të përcaktohen dhe për pasqyrat financiare të konsoliduara konform dhe kërkesave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Menjëherë

9.2. Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës të miratohen politikat e amortizimit të aseteve të shoqërisë, duke përcaktuar % amortizimi nën nivelin e limiteve të vendosura në ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

Menjëherë

9.3. Rekomandimi: Nga Administratori dhe Drejtoria e Ekonomike të merren masa duke përcaktuar rregulla të brendshme me afate kohore konform akteve në fuqi, të dorëzimit të raportit të rezultateve të inventarizimit të aseteve të shoqërisë për filialet, ashtu dhe për

Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare, në mënyrë që i gjithë procesi të përfundojë brenda vitit kalendarik dhe brenda afateve sa më të shkurtra vazhdimi i procesit të vendimmarrjeve për daljet jashtë përdorimit.

Menjëherë

9.4. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike për efekt të shmangies së riskut të mosnjohjes së shpenzimeve nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të shoqërisë, të njoftohen organet tatimore për çdo rast të nxjerrjes jashtë përdorimit, konform kërkesave të parashikuara në aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Rekomandimet e auditimit të mëparshëm janë dërguar me shkresën e KLSH nr. 1053/23, datë 30.04.2015. Nga Posta Shqiptare sha me shkresën 3715, datë 3.11.2015 brenda afatit 6 mujor i është dhënë përgjigje KLSH në zbatim të nenit 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014” Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Citojmë gjithashtu se zbatimi i rekomandimeve është audituar dhe me autorizimin e KLSH nr. 1073/5, datë 20.11.2015 për të cilën në Postën Shqiptare është dërguar pjesë e raportit të zbatimit të rekomandimeve si dhe rekomandimet për zbatimin e menjëhershëm të rekomandimeve të pa zbatuara dhe në proces (nr.1,14,16,19,22,29,30 për masa organizative) me shkresën e KLSH nr. 1073/46, datë 29.01.2016. Nga ana e Postës Shqiptare sha me shkresën 388/1 datë 21.03.2016 është kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të pa zbatuara dhe atyre në proces. Nga verifikimi dhe përgjigja e Posta Shqiptare sha (Drejtorja e Auditimit) për ecurinë e rekomandimit u dhanë vlerësime për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme, nga ku rezultoi se rekomandimi 1,14,16,19,29,30“ Masa Organizative” janë në proces realizimi dhe realizuar pjesërisht (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 113-116 të Raportit të Auditimit*).

10.1 Rekomandimi: Nga Shoqëria Posta shqiptare SHA të merren masat për realizimin e plotë të rekomandimeve për masa organizative sa më sipër cituam.

Menjëherë

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi u konstatuan sa më poshtë:

-Për vitin 2017 aktiviteti i mbledhjeve është zhvilluar pa një rend dite të përcaktuar nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës duke mos specifikuar kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjeve.

-Për vitet 2018 dhe 2019 procesverbali i mbledhjeve nuk është mbajtur në formën e një regjistri por në formatin e letrave A4 duke mos e pasqyruar në rrjedh kronologjike vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës.

-Për periudhën objekt auditimi, KM nuk e ka zhvilluar veprimtarinë vjetore bazuar në një program vjetor të miratuar për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria.

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka raportuar për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, jo më pak se 4 herë në vit, në Ministrisë së linjës, MFE në cilësinë e pronares (aksionare) e vetme e shoqërisë si dhe nuk është verifikuar dhe kontrolluar brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar, raportin e drejtorisë dhe të ekspertit kontabël.

-Nuk është kontrolluar ose mbikëqyrur nga Këshilli Mbikëqyrës zbatimin e politikave tregtare të Administratorit në shoqëri.

-Nga auditimi u konstatua se nga Administratori i Shoqërisë “Posta Shqiptare” SHA nuk është raportuar çdo tremujor mbi ecurinë dhe aktivitetin e shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës.

-Nga auditimi u konstatua se emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve kandidatë të Qendrave Rajonale të shoqërisë Posta Shqiptare SHA nuk i janë propozuar Këshillit Mbikëqyrës për

aprovim nga Administratori veprime këto në kundërshtim me statutin e shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-54 të Raportit të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të merren masa për sa më poshtë:

- Të raportojë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë jo më pak se 4 herë në vit, duke filluar që nga viti aktual.
- Të hartojë dhe miratojë menjëherë programin vjetor të veprimtarisë për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë Këshilli apo Drejtoria.
- Të verifikojë dhe kontrollojë brenda afateve të përcaktuara ligjore mbylljen e vitit financiar, raportin e drejtorisë dhe të ekspertit kontabël.
- Të kontrollojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë Posta Shqiptare sha.

Vazhdimisht

11.2 Rekomandimi: Të merren masat nga ana e Administratorit për hartimin e raporteve 3 mujore mbi ecurinë e shoqërisë dhe më pas raportimin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë.

Vazhdimisht

11.3 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masat që të prezantojë dhe propozojë në Këshillin Mbikëqyrës kandidatët në të ardhmen dhe Drejtorët aktual të Drejtorive në Filiale sipas kompetencave ligjore.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Posta Shqiptare sh.a nuk ka Strategji risku, regjistër risku të miratuar si dhe manualin e menaxhimit të riskut që të përmbajë identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Gjithashtu nuk është caktuar koordinatori risku. Nuk është krijuar një regjistër riksues për gjithë aktivitetin e Posta Shqiptare sh.a ku të jenë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive, në shërbim të minimizimit të riskut të mashtrimeve dhe parregullsive. Nuk ka të hartuar pyetësor të vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar si dhe nuk ka të hartuar raport për Këshillin Mbikëqyrës për nivelin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 12-18 të Raportit të Auditimit*).

12.1 Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm e menaxhimit financiar, duke zbatuar kërkesat e parashikuara nga ligji si dhe duke kryer procedurat hap pas hapi konform kërkesave të tij dhe akteve në zbatim. Të merren masa për ngritjen e kapaciteteve të menaxherëve dhe stafit të Posta Shqiptare sha në drejtim të njohurive dhe implementimit të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Menjëherë

13. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike të shoqërisë rezultoi se nga krahasimi i numrit total të punonjësve të programuar dhe të realizuar ka rezultuar një diferencë prej 26 punonjësish më pak për vitin 2017, 20 punonjës më pak për vitin 2018 dhe 70 punonjës më pak për 6 mujorin e parë të 2019. Gjithashtu nga krahasimi i fondit të pagave të programuar dhe të realizuar ka rezultuar një mos realizim i fondit të pagave për vitin 2017 në vlerën 32,575,000 lekë dhe 27,908,000 lekë për vitin 2018. Nisur nga këto diferenca dhe mos realizime, mund të shprehemi me rezervë për planifikimin dhe analizimin e zërit të shpenzimeve për paga gjatë hartimit të programimit ekonomik të shoqërisë. Duke sjellë kështu një programim jo të saktë dhe të argumentuar mirë për zbatimin e numrit mesatar të

punonjësve dhe fondit të pagave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 55-64 të Raportit të Auditimit*).

13.1Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Ekonomisë të analizohet në mënyrë periodike treguesit e fuqisë punëtore (numrin mesatar të punonjësve, pagën mesatare dhe fondin e pagave) në përputhje me objektivat ekonomik dhe financiar të shoqërisë, në mënyrë të tillë që planifikimi vjetor për fondin e pagave të llogaritet në bazë të nevojave dhe jo të tejkalohet, pasi ky fond mund të ishte përdorur për nevoja të tjera të shoqërisë.

Vazhdimisht

14. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Rregullores së Brendshme të Institucionit nr. 6 datë 20.02.2018 u konstatua se detyrat e secilit pozicion janë të përcaktuara por nuk janë përcaktuar kriteret e kualifikimit për secilin pozicion pune si dhe nuk janë përcaktuar kriteret për procedurat e marrjes në punë, konkurrimin dhe vlerësimin e kandidatëve. Nga procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të ndjekur, as të kriterëve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.

Gjithashtu, nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit për 15 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare sha u konstatua një rast ku diploma e një punonjëse nuk përputhej me kriterin arsimor të pozicionit të punës të miratuar në Strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 55-64 të Raportit të Auditimit*).

14.1Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa, për ndërprerjen e praktikave të tilla, të hartojë dhe zbatojë plotësisht procedurat rekrutimit të punonjësve, si dhe të marrë masa për përcaktimin e kriterëve të rekrutimit, për çdo pozicion pune, duke i bërë pjesë të Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të shoqërisë Posta Shqiptare SHA.

Menjëherë

15. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se që prej vitit 2016 Shoqëria nuk ka një Kontratë kolektive që të rregullojë marrëdhëniet e punës dhe të përmbajë dispozitat mbi kushtet e punësimit, lidhjen, përmbajtjen dhe përfundimin e kontratave individuale të punës. Kjo sepse Shoqëria ka shkëputur marrëdhëniet kontraktuale me Sindikatën e Pavarur të Industrisë, Energjetikës dhe Security të Shqipërisë nënshkruar më datë 18.03.2015 dhe aktualisht çështja është duke u ndjekur në gjykatë. Kontratat individuale të punës, pjesë e dosjes së punonjësve, ishin me afat një vjeçar dhe me afat të përcaktuar rinovimi për një vit tjetër shtesë. Marrëdhëniet kontraktuale të punës nëpërmjet kontratave individuale nuk janë rinovuar për tu përshtatur me ndryshimet e reja të Statutit të Shoqërisë, Strukturën Organizative të ndryshuar dhe nivelet e reja të pagave të shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 55-64 të Raportit të Auditimit*).

15.1Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare SHA të merren masa të menjëhershme për rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale të punës nëpërmjet Kontratave Kolektive dhe individuale në të cilat do të parashikohen dispozitat mbi kushtet e punësimit, lidhjen, përmbajtjen dhe përfundimin e kontratave individuale të punës dhe të përshtaten me ndryshimet në Shoqërisë Posta Shqiptare SHA të Statutit, Strukturës Organizative të ndryshuar dhe nivelet e reja të pagave të shoqërisë.

Menjëherë

16. Gjetje nga Auditimi: Gjatë periudhës objekt auditimi niveli i pagave të punonjësve ka ndryshuar dy herë me vendimin Qarkullues nr. 9 dhe nr. 28 datë 21.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës. Nga auditimi i veprimtarisë vendimmarrëse të Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se niveli i pagave dhe ndryshimi i nivelit të pagave për punonjësit e shoqërisë Posta Shqiptare

SHA nuk janë të miratuara nga Ministria përkatëse, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 55-64 të Raportit të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Nga ana e Administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Posta Shqiptare sha të merren masa për vënien në dijeni dhe aprovimin e nivelit aktual të pagave të detajuar për çdo pozicion pune të shoqërisë nga Ministria përkatëse si dhe të ndiqet kjo praktikë për çdo ndryshim në të ardhmen në nivelin të pagave të shoqërisë.

Vazhdimisht

17. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër prokurimi nr. 7 datë 22.06.2018 ka filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbimin ndërfaqe ndërmjet sistemit E. dhe kompanisë D.”. Nga auditimi i kësaj procedure rezultoi se nuk është zgjedhur procedura e duhur e prokurimit, pasi fondi limit tejkalon kufirin ligjor për prokurime me vlera të vogla, duke qenë se shërbim i ngjashme, është kryer për Procedurën e prokurimit të hapur në vlerën 25,000,000 lekë.

Gjithashtu, nga verifikimi i specifikimeve teknike të hartuara nga grupi i ngritur me UB nr. 345 datë 18.06.2018 dhe ftesës për ofertë të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor rezultoi se është kërkuar që kapacitetet teknike që duhet të ketë OE të jenë zotërimi i të Drejtës së Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare si dhe të disponojë kodin në burim, pasi posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod. Nisur nga sa është kërkuar specifikimet teknike për procedurën e blerjes me vlerë të vogël janë diskriminuese dhe pengesë për konkurrencën e hapur në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Ligji për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 2, parimet e përzgjedhjes, germa (a), germa (b) dhe germa (c) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, pasi i vetmi operatorë i cili zotëron të Drejtën e Autorit dhe kodin në burim është operatori Helius System shpk i cili është shpallur fitues (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 65-71 të Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me njësitë vartëse, për të programuar saktë nevojat për prokurimet me vlera të vogla për punë, mallra dhe shërbime, të përcaktojnë grup mallra e shërbime sipas natyrës së përdorimit, për të shmangur copëzimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit me efektivitet, transparencë dhe konkurrencë të operatorëve ekonomikë.

17.2 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të tregohet kujdes gjatë hartimit të specifikimeve teknike me qëllim eliminimin e mangësive për kryerjen e një procedure sa më transparente e duke nxitur konkurrencën.

Vazhdimisht

18. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i praktikave të pagesave me bankë, u konstatua se nga likuidimi i faturës nr. 120 datë 1.07.2018 për shërbimin “Mirëmbajtje ETERNA”, për OE H. S., në procesverbalin bashkëlidhur faturës nuk është bërë asnjë sqarim mbi gjetjen dhe riparimin e problemeve nga OE ose përshkrimi i situatës në rast se sistemi ka qenë në punë të plotë dhe pa problem (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 65-71 të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga grupi i ndjekjes së zbatimit të kontratës të merren masa menjëherë për hartimin dhe dokumentimin e plotë të veprimeve ose ngjarjeve duke pasqyruar me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratës.

Vazhdimisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël të realizuara nga Filiali Lezhë u konstatua se në të gjitha procedurat mungonte kërkesa e drejtorisë së shërbimeve për iniciimin e blerjes (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 65-71 të Raportit të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Filialit Lezhë të marrë masat menjëherë që për çdo procedurë të ndjekur në të ardhmen të iniciohet nga kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve në mënyrë të tillë që mallrat e prokuruar të bazohen në një analizë të dokumentuar të nevojave, bazuar edhe në gjendjen reale të artikujve/mallrave në magazinë duke e bërë praktikën sa më transparente.

Vazhdimisht

20. Gjetje nga auditimi: Me kërkesën datë 11.02.2019 për “Riparimin e gjeneratorit të dhomës së serverave” drejtuar komisionit të prokurimeve me vlera të vogla nga drejtori i IT dhe Zhvillimit, ka nisur procedura ku kanë sjellë ofertat 3 operatorë ekonomik me datë 13.02.2019 dhe është shpallur fitues operatori “I.S. I. sh.p.k” me oferten me të ulët në vlerën 92,600 lekë pa t.v.sh. Është kryer likuidimi i faturës nr.08, datë 13.02.2019 ndaj këtij operatori me transaksionin bankar datë 27.02.2019 në shumën 111,120 lekë me t.v.sh. Në këtë procedurë u konstatua se nuk është kryer asnjë akt-kontrolli përpara kërkesës për servis ku të identifikoheshin saktë defektet e pësura edhe arsyet e nga se është shkaktuar. Gjithashtu u konstatua se edhe pas shërbimit të kryer nuk është mbajtur asnjë procesverbal i riparimit të gjeneratorit. Si konkluzion, procedura e ndjekur për këtë shërbim nuk është e rregullt pasi nuk evidenton shërbimin e kryer për riparim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 82-90 të Raportit të Auditimit*).

20.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike të mos kryhen likuidime pa pasur gjithë dokumentacionin e mundshëm të kryerjes së shërbimit referuar funksioneve të N/Z në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike të vendosura në DST për procedurat e prokurimit me objekt: **a).** “Kalimi i sistemit ETERNA në web dhe zhvillime të tjera, programi i informatizimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financë kontabilitet si dhe sistem software për ndjekjen dhe menaxhimin e çështjeve help-desk”, viti 2017 me fond limit 29,500,000 lekë, **b).** “Mirëmbajtja e sistemit Eterna”, viti 2019 me fond limit 9,450,000 lekë dhe **c).** “Eterna Gateway Application”, viti 2018 me fond limit 25,000,000 lekë, u konstatua se janë vendosur kritere diskriminuese duke shmangur konkurrencën e lirë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nen 2, parimet e përzgjedhjes, gërma (a), gërma (b) dhe gërma (c) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

21.1 Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, sektori prokurimeve, grupet e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të marrin masa që në të ardhmen, në hartimin e Dokumenteve Standarde të procedurave të prokurimit, të shmangin vendosjen e kriterëve diskriminuese për të krijuar kushtet e një konkurrence të lirë për pjesëmarrjen në tender të sa më shumë operatorëve ekonomik.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: **a).** “Fushatë publicitare në median e shkruar online ‘Dixhitale’, median e shtypur dhe median në ambientet e jashtme”, viti 2017 me fond limit 9,785,283.86 lekë, **b).** “Fushatë publicitare në median vizive”, viti 2018 me fond limit 4,900,000 lekë dhe **c).** “Fushatë publicitare në median online”, viti 2018 me fond limit 6,980,000 lekë, u konstatua se nuk është argumentuar nevoja e kryerjes së fushatave. Mungon analiza ekonomike tek e cila duhej të pasqyroheshin në mënyrë të detajuar, përfitimet ekonomike që do të kishte Posta Shqiptare duke kryer këtë investim. Kërkesa për nevojën e kryerjes së investimit nga Drejtori i Marketingut, nuk është e argumentuar. Nuk ka asnjë dokument ku të pasqyrohej një krahasim midis periudhave të mëparshme nëse ka pasur rënie të ardhurave apo nëse ka qenë mungesa e fushatës publicitare që ka sjellë rënie të ardhurave. Nuk ka asnjë parashikim për rritjen e të ardhurave në rast të kryerjes së një fushate publicitare dhe as ndonjë reacion pas përfundimit të fushatës

publicitare. Drejtoria e Marketingut, nuk ka paraqitur një plan të qartë vjetor të nevojave për reklamë dhe publicitet duke mos theksuar ndikimin që ka publiciteti në zhvillimin e shoqërisë dhe arritjen e objektivave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

22.1 Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria e Marketingut, Drejtoria Ekonomike, të bashkërendojnë punën për kryerjen e një analize profesionale ekonomike duke krahasuar elementët dhe gjendjen ekonomike të institucionit përpara fillimit të një fushate publicitare me ato pas përfundimit të saj me qëllimin e vetëm, arritjen e objektivave afatgjatë të Postës Shqiptare, të përcaktuara në rregulloren e brendshme por edhe në aktet ligjore e nënligjore.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Eterna Gateway Application për 4 vite”, viti 2019 me fond limit 20,000,000 lekë, tek specifikimet teknike në DST, është përshkruar se duhet të mirëmbahen funksionet Eterna Gateway. Funksionet e sistemit Eterna Gateway, janë implementuar në vitin 2018 sipas procedurës së prokurimit me objekt “Eterna Gateway Application” (Implementim). Posta Shqiptare SHA, nuk ka asnjë të ardhur nga implementimi i kontratës së mëparshme e si rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë arsye për të mirëmbajtur një sistem i cili nuk është vënë në punë. Fillimi i një procedure prokurimi për mirëmbajtjen e një sistemi që akoma nuk ka sjellë të ardhura financiare për institucionin pas implementimit të tij, do të krijojë në të ardhmen, vetëm shpenzime me efekte negative për Postën Shqiptare SHA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

23.1 Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria e IT, të marrin masa që në të ardhmen, përpara kryerjes së një procedure prokurimi, me objekt mirëmbajtje të sistemeve IT, të analizojnë kapacitetet profesionale të stafit inxhinierik të Drejtorisë së IT, e në vazhdim, vetëm nëse nuk përmbushen kriteret profesionale, të kryejnë mirëmbajtjen me të tretë duke argumentuar më parë nevojat për mirëmbajtje në rakordim me Drejtorinë Ekonomike për të analizuar ekonomikisht investimin në favor të buxhetit të shoqërisë.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt:

a) “Shërbimi Intranet/Internet në zyrat Postare në filiale e Degë të Posta Shqiptare SHA” me fond limit 39,473,200 lekë, viti 2018;

b) “Mirëmbajtje e sistemit Voip + Upgrade” viti 2018 me fond limit 8,000,000 lekë;

U konstatua se grupet e monitorimit nuk kanë bashkangjitur procesverbalit të kryerjes së shërbimit, asnjë diagramë mbi monitorimin e trafikut të intranet/internetit në rastin a) dhe të ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes në rastin b), duke e bërë të pa mundur auditimin e kryerjes ose jo të shërbimit sipas sasive të intranetit të prokuruar apo edhe të mirëmbajtjes sipas objekteve të procedurave të prokurimit. Thjesht dhe vetëm mbajtja e procesverbaleve nga grupet e monitorimit, duke përcaktuar se “Shërbimi i ofruar nga kontraktuesi për filialet dhe degët e Postës Shqiptare, përmbush kërkesat e kontratës në të gjitha zyrat postare.....” pa përcaktuar mënyrën e monitorimit pra pa përshkruar sasinë e mbps të internetit të ofruar apo mënyrën e monitorimit për mirëmbajtje dhe arsyet e dëmtimit të pajisjeve, nuk përbën në vetvete një raport monitorimi. Gjithashtu, referuar rastit a), vlera e likuiduar në total është 21,986,972.6 lekë dhe jo sa është vlera e kontratës pra 43,973,856 lekë me TVSH. Nuk ka asnjë shpjegim në dosjen e zbatimit të kontratës lidhur me mos likuidimin në total të vlerës së prokuruar. Si rrjedhojë, në pamundësi për të vërtetuar sasinë e mbps të ofruar sipas kontratës, (jo për fajin e grupit të monitorimit pasi ai i është referuar kontratës dhe kushteve të zbatimit të saj) vlera e mbetur pa likuiduar, do të mbetet e tillë deri në momentin që bashkimi i operatorëve ekonomik “C. P.” SHPK & “A.” SHA, do të paraqesin pranë Postës Shqiptare SHA, raportet e monitorimit të trafikut internet/intranet të nënshkruara nga palët. Grupi i

auditimit, nuk mund të kalkulojë sasi të “data” që kanë përdorur ose jo zyrtar postare dhe si rrjedhojë nuk mund të jap opinion nëse kontrata është përmbushur 100 % sipas specifikimeve teknike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

24.1.a Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e IT, të marrin masat që përpara se të likuidojnë vlerën e mbetur pa likuiduar, të kërkojnë nga operatori ekonomik, diagramat e trafikut të internet/intranet të monitorimit në kohë reale sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë

24.2.a Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Juridike, Drejtoria e IT, të marrin masat që në të ardhmen, në hartimin e kushteve të zbatimit të kontratave për shërbimet internet/intranet, të përfshijnë dhe dorëzimin e diagramave të monitorimit të trafikut për të vërtetuar kryerjen e shërbimit në sasi dhe cilësi përpara likuidimit të shërbimit.

Menjëherë

24.3.a Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, sektori juridik, të marrin masa që në të ardhmen, në hartimin e urdhrave për ngritjen e komisioneve të ndjekjes dhe zbatimit të kontratave, të përcaktojnë detyrat e secilit anëtar të grupit për respektimin e afateve të kontratave apo marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave.

Menjëherë

24.4.b Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria e IT, të marrin masat që në të ardhmen, për të vërtetuar shërbimet e kryera për mirëmbajtjen e sistemeve IT, të mbajnë raporte të detajuara për sasinë dhe llojin e shërbimit të ofruar apo defektit me qëllim, marrjen e masave për minimizimin e tyre dhe nxjerrjen e përgjegjësive nëse ka.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative dhe fondi i pagave në Filialin Shkodër rezultoi se për vitin 2018 dhe për 5mujorin e parë të vitit 2019 struktura e programuar ishte tejkalar me një numër mesatar prej 3 punonjës duke rezultuar dhe me një tejkalarim i shpenzimeve për paga në vlerën **963,000 lekë** për vitin 2018, ku nga 58,914,000 lekë të planifikuara janë realizuar 59,877,000 lekë dhe për 5mujorin e parë të vitit 2019 u konstatua një tejkalarim prej **416,000 lekë** nga 24,751,000 lekë në 25,167,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 116-123 të Raportit të Auditimit*).

25.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Filiali Shkodër të merren masa të menjëhershme për respektimin e strukturës së miratuar të punonjësve në mënyrë të tillë që mos të tejkalohej fondi i pagave të programuara për këtë Filial.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Me urdher prokurimi nr. 6 datë 10.05.2018 ka filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbimi e-learning”. Nga procedura është shpallur fitues operatori ekonomik “K. INC” i cili ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni i paraqitur nga OE i shpallur fitues nuk ka qenë i plotë sipas kërkesës në ftesën për ofertë. K. INC nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton se K. INC është i njohur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë siç kërkohet në ftesën për ofertë datë 10.05.2018.

Më datë 16.05.2018 është lidhur kontrata nr. 6/1 për një afat 365 ditë ndërkohë që sigurimi i kontratës ka afat deri në datë 16.06.2018 ose 1 muaj nga nënshkrimi i kontratës duke mos mbuluar të gjithë aktivitetin e kontratës në kundërshtim me nenin 10, pika 2 e kontratës nr. 6/1 datë 16.05.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 82-90 të Raportit të Auditimit*).

26.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të blerjeve me vlerat të vogla të marrë masa që në të gjitha rastet e prokurimit të mallrave me vlera të vogla të plotësojë dokumentacionin e plotë për pritjen dhe kolaudimin e mallrave të prokuruar.

26.2 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të kërkojë si kusht nga Operatorët Ekonomikë që Sigurimi i Kontratës të mbulojë të gjithë afatin e zbatimit të kontratës në mënyrë të tillë që në rast se OE nuk plotëson kushtet e kontratës të mbahet prej tij sigurimi i kontratës.

Vazhdimisht

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se shpeshherë bëhen gjetje duke i trajtuar si fenomene por nuk shoqërohen me rekomandime dhe masat përkatëse disiplinore për personat përgjegjës, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, date 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 6 pika c. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në Drejtorinë e Përgjithshme ku janë të përqendruara procedurat për të gjitha aktivitetet e Postës Shqiptare si planifikim treguesish, marketimi, procedura prokurimi, monitorimi i programeve të IT të instaluar, etj. të cilat janë të rëndësishme në veprimtarinë e Postës Shqiptare dhe ku auditimi i vazhdueshëm për veprimtaritë e drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme del i rëndësishëm në lidhje me efektivitetin dhe menaxhimin e fondeve të saj. Gjithashtu e gjithë Posta Shqiptare e kryen veprimtarinë e shërbimit nëpërmjet programeve të instaluar, për rrjedhojë del i domosdoshëm dhe auditimi i IT që aktualisht mbulohet nga një specialist i Drejtorisë së Auditimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 12-18 të Raportit të Auditimit).

27.1 Rekomandim: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të marrë masa që në të ardhmen të planifikojë në programet e auditimit, auditimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA në të gjitha drejtoritë që ka në përbërje ky institucion.

Menjëherë

27.2 Rekomandim: Nga e Drejtoria e Auditit të Brendshëm, duhet që gjetjet e rezultuara të shoqërojnë me masat përkatëse përmirësuese nëpërmjet rekomandimeve dhe të fuqizojë stafet e saj me trajnime në fushën auditimit të IT.

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Janë konstatuar dëme ekonomike në masën 6,969,270 lekë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i situacionit përfundimtar dhe zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë katesh të Godinës Administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA dhe Drejtorisë së Filialit Tiranë”, viti 2013, u konstatua se pajisjet për zërin “Makineri Pajisje”, në situacionin përfundimtar të kontratës bazë dhe asaj shtesë, janë llogaritur me TVSH duke i konsideruar si punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve. Si përfundim, është likuiduar tepër në favor të sipërmarrësit të punimeve, vlera 4,070,200 lekë pasi është përfshirë TVSH-ja e pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë dhe atë shtesë vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe duhet dëmshpërblyer nga operatori ekonomik “J.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Juridike, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej **4,070,200 lekë, nga operatori ekonomik “J” SHPK, si vlerë që është dëm ekonomik** për Postën Shqiptare SHA, nga likuidimi i vlerës së TVSH për zërin makineri pajisje.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Fushatë publicitare në median vizive”, viti 2018 me fond limit 4,900,000 lekë, u konstatuan vonesa në ekzekutimin e kontratës jashtë afateve të përcaktuara. Referuar nenit 10, të kontratës së lidhur, penalitetet, kemi: $5,820,000 * 4/1000 * 69$ ditë vonesë = 1,606,320 lekë. Kjo vlerë, është dëm ekonomik për Postën Shqiptare SHA dhe duhet të dëmshpërblehet nga “E. 4” person fizik me përfaqësues znj. V. M. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Postës Shqiptare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,606,320 lekë, nga operatori ekonomik “E.4” person fizik me përfaqësues znj. V. M,** si vlerë që i përket penaltetit për ekzekutimin e kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *“Kalimi i sistemit ETERNA në web dhe zhvillime të tjera, programi i informatizimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financë kontabilitet si dhe sistem software për ndjekjen dhe menaxhimin e çështjeve help-desk”*, viti 2017 dhe me fond limit 29,500,000 lekë, u konstatuan vonesa në ekzekutimin e kontratës jashtë afateve të përcaktuara. Referuar nenit 23 të kontratës së lidhur për likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar, pika 23.1, vlera e penaltetit, do të llogaritet me tarifën ditore 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar. Vlera në total e penaltetit që i duhej mbajtur operatorit ekonomik “H. S.” SHPK, është 775,200 lekë. Grupi i auditimit, i është referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në kohën e auditimit i cili ka pasur paqartësi dhe mangësi që janë sjellë me observacionet e mëvonshme. Si rrjedhojë nuk mund të shprehemi në lidhje me ekzistencën ose jo të dëmit në fakt. Ndaj Posta Shqiptare SHA, duhet ta analizojë këtë gjetje të grupit të auditimit pas marrjes së raportit përfundimtar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e IT, të analizojnë dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik “H. S.” SHPK, lidhur me afatet e ekzekutimit të kontratës dhe penaltetit prej 775,200 lekë të konstatuar nga grupi i auditimit, duke pasur në konsideratë qëllimin e kryerjes së shërbimit dhe të arritjes së objektivave të institucionit dhe në varësi të fakteve dhe argumenteve, të vendoset nëse do të mbahet penalteti i përcaktuar në raportin e auditimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Posta Shqiptare për vitet 2017, 2018, 2019 (periudhë auditimi) ka lidhur kontratë për furnizimin me karburant me dy kontraktorë:

b.1- Me E. D. A. Sha është lidhur kontrata me nr. 2090/6 datë 08.09.2017 me ndryshime me kontratën nr.2689, datë 10.09.2018 (ndryshimet kanë të bëjnë me shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës deri në marrjen e furnizimit të plotë të sasisë dhe realizimit të vlerës së kontratës). Vlera e kontratës është 65,079,048 lekë me TVSH për 382,000 litra gazoil me marzh fitimi 21% dhe 12,761,100 lekë me TVSH për sasinë 75,000 litra benzinë dhe marzh fitimi 22%.

b.2. Kontrata me nr.2886/6 datë 3.12.2018 me operator K. Shpk & K. Sha me afat furnizimi 1 vit dhe vlerë kontrate 62 139,490 lekë pa TVSH dhe 63,155,379.6 me TVSH dhe sasi të 69,240 litra benzinë me vlerë 9,510,007 lekë dhe 11,412,008.4 me TVSH dhe marzh fitimi 17.7% dhe 369,600 litra gazoil me vlerë 52,629,483 lekë me marzh fitimi 16.7% .

Gjatë auditimit të dokumentacionit të vendosur bashkëlidhur likuidimit të bankës rezultoi se për kontratën E. D. A. Sha kontraktori ka vendosur bashkëlidhur dhe llogaritjen e çmimit për çdo faturë të paraqitur sipas elementëve përbërës të tij. Në elementët përbërës të çmimit nga ana e kontraktorit është përfshirë dhe Taksa e markimit në masën 0.614 për i litër gazoil dhe benzinë .

Referuar akteve në fuqi taksa e markimit apo e shënimi nuk është element i çmimit të karburanteve, por referuar përcaktimeve të paraqitura në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, është një shpenzim dhe detyrim i çdo operatori. Në këtë mënyrë operatori ka shkaktuar rritje të vlerës për litër karburanti të furnizuar, në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me aktet në fuqi për elementet e çmimit të karburanteve të paraqitura dhe në udhëzimin e APP. Në total gazoil dhe benzinë në vlerën **370,413 lekë** është shuma e

përfiturar më shumë nga E. D. A. SHA si rezultat i aplikimit në çmim të taksës së markimit detyrim i tij. Kjo shumë përbën dëm ekonomik detyrim për kthim nga E. D. A. Sha. dhe në total gazoil dhe benzinë në vlerën **152,124 lekë** është shuma e përfiturar më shumë nga K. Shpk & K. SHA (nga furnizimi deri më (1.06.2019) si rezultat i aplikimit në çmim të taksës së markimit detyrim i tij. Kjo shumë përbën dëm ekonomik detyrim për kthim nga K. Shpk & K. Sha.

Në veçanti nga kontrata me E.D.A. Sha kontrata me K. Shpk & K. Sha ka të përcaktuar në nenin 3.2 të saj se në çmimin e kontratës është i përfshirë përveç të tjerave dhe tarifa e shënimit të karburanteve. Përfshirja e tarifës së shënimit apo të markimit, bie në kundërshtim me taksat dhe tarifat e përcaktuara në aktet në fuqi. Kjo taksë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 është një shpenzim dhe detyrim i çdo operatori para tregtimit të mallit.

Referuar observacioneve të paraqitura ka rezultuar se nga Posta Shqiptare Sha janë nisur procedurat për arkëtimin e shumave me shkresat nr. 2121 6.08.2019”Njoftim detyrimi operatorit “E. D.” SHA, dhe shkresat nr.2119, datë 6.08.2019 “Njoftim detyrimi” si dhe shkresa me nr.2120, datë 6.08.2019 “Kërkesë për arkëtim shume”dërguar bashkimit të operatorëve “ K.” shpk & “K” SHA ku njoftohen për arkëtimin e shumës të marrë padrejtësisht prej 152,124 lekë deri më 1.06.2019 dhe shumën prej 25,013.64 lekë për periudhën 1.06- 31.07.2019(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 71-81 të Raportit të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse të Posta Shqiptare SHA, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **370,413 lekë**, nga Operatori Ekonomik E.D.A. SHA, për përfitim të padrejtë nga aplikimi i taksës së markimit në çmimin e karburantit në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë

4.2-Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse të Posta Shqiptare SHA, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **177,137.6 lekë**, nga bashkimit të operatorëve “ K” shpk & “K” SHA, për përfitim të padrejtë nga aplikimi i taksës së markimit në çmimin e karburantit në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi ka rezultuar se me urdhërin e prokurimit nr. 02, datë 19.03.2019, komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla ka filluar procedurën e prokurimit për “*Hartim i projekteve të rikonstruksioneve të zyrave Filialet Tiranë, qendra Tranzite dhe Durrës*” me fond limit 785,862 lekë. Me procesverbalin e datës 21.03.2019 komisioni ka bërë skualifikimin e disa operatoreve me arsyetimin e përlllogaritjes jo të saktë të ofertës së paraqitur referuar rekomandimit të APP dhe me datë 21.03.2019 është shpallur si ofertë fituese operatori ekonomik “I.18” me vlerë oferte 943,034 lekë me tvsh. Komisioni i blerjeve të vogla ka bërë s’kualifikimin të operatorit “A. C.” me ofertën ekonomike **896,400 lekë** cila është vlerë mbi minimumin e llogaritur nga komisioni konform rekomandimit të APP në zbatim të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, që do të thotë se operatori ekonomik është s’kualifikuar pa të drejtë nga konkurrimi. Citojmë se oferta e operatorit fitues është e njëjtë me fondin limit të përlllogaritur nga ana e njësisë së prokurimit.

Diferenca në shumën 46,634 lekë me TVSH midis vlerës së ofertës fituese me vlerën e operatorit të s’kualifikuar padrejtësisht përbën dëm ekonomik për shoqërinë Posta Shqiptare (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 82-90 të Raportit të Auditimit*).

5.1Rekomandim:Nga Posta Shqiptare SHA të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjithë procedurat administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për të kërkuar shpërblimin e dëmit

ekonomik, në vlerën **46,634 lekë**, të shkaktuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të përbërë nga znj. M. H, znj. E. B, dhe znj. J. N.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se është kryer pagesa paradhënie për pritje përcjellje me mandat pagesë nr.9, datë 17.04.2019 në vlerën 60,000 lekë në bazë të programit të punës nr. 778/1 prot., datë 01.04.2019 të miratuar nga titullari i Postës Shqiptare SHA. Paradhënia nuk është mbyllur me argumentin se nuk janë paraqitur deri në këtë moment asnjë dokumentacion justifikues si fatura tatimore e shoqëruar me kupon tatimor e cila të tregojë shërbimin e marrë dhe vlerën e shpenzuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 82-90 të Raportit të Auditimit*).

6.1Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë Ekonomiketë kërkohet mbyllja e paradhënies në shumën 60,000 lekë dhe argumentimi me dokumente ligjore të justifikimit të shpenzimit brenda periudhës së shqyrtimit të këtij raporti. Në mungesë të këtij dokumentacioni shuma paradhënie të konsiderohet dëm ekonomik duke ndjekur procedurat administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për punonjësit që kanë përgjegjësi në shpenzimin e paradhënies.

Menjëherë

D.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Janë konstatuar efekte negative financiare në masën 145,698,753.14 lekë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Fushatë publicitare në median online*”, viti 2018 me fond limit 6,980,000 lekë, u konstatua se grupi i përllogaritjes së vlerës së fondit limit, nuk i ishte referuar kontratës së mëparshme por tregut. Si rrjedhojë, rezultoi se kontrata e mëparshme ishte me vlerë më të ulët dhe kriteret ishin pothuajse të njëjta. Diferenca e fondit limit të përllogaritur në kontratën e mëparshme dhe ajo e përllogaritur në këtë procedurë, është **2,094,716.14 lekë**. **Kjo vlerë, është efekt negativ financiar për PSH SHA** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Marketingut, të marrin masat për argumentimin e fondeve limite të fushatave publicitare, me qëllim mos kryerjen e investimeve me vlera që nuk justifikojnë objektivin e përcaktuar më parë dhe që mund të shkaktojnë efekte financiare negative për buxhetin e Postës Shqiptare SHA.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Eterna Gateway Application*”, viti 2018 me fond limit 25,000,000 lekë, u konstatua se nuk është argumentuar nevoja e kryerjes së këtij shërbimi. Mungon analiza ekonomike tek e cila duhej të pasqyroheshin në mënyrë të detajuar, përfitimet ekonomike që do të kishte Posta Shqiptare duke kryer këtë investim. Relacioni për nevojën e kryerjes së investimit nga Drejtori i IT & Zhvillimit, z. E. S., sipas shkresës me nr. 123/b prot., datë 03.05.2018, nuk është i argumentuar. Për më tepër, nuk ka asnjë kërkesë bashkangjitur ku të pasqyrohej interesimi nga institucionet financiare (bankat) për të integruar sistemet e tyre me atë të Postës Shqiptare. Nuk ka asnjë dokument ligjor ose marrëveshje të lidhur midis Postës Shqiptare dhe ndonjë institucioni bankar përpara procedurës së prokurimit ku të vërtetohej se ndonjë institucion bankar ka interes për të integruar sistemin e tij me atë të Postës Shqiptare. Për më tepër, shpjegimet e dhëna tek specifikimet teknike të kërkuara dhe konkretisht sipas shkresës me nr. 1630/1 prot., datë 09.05.2018, cilësojnë dhe rrjedhën e veprimeve që duhet të kryejë sportelisti/tja. Nuk ka asnjë dokument, analizë, relacion apo edhe parashikim nga Drejtoria e

Postës Shqiptare SHA se nëse do të rriten, sa do të rriten të ardhurat ekonomike dhe klientët nga implementimi i këtij aplikacioni (siç përmendet tek kërkesa e Drejtorit të IT) i cili në vetvete, nuk është gjë tjetër veçse një aplikacion që ka ekzistuar edhe më parë. Posta Shqiptare SHA, ka kryer procedura prokurimi në të kaluarën që prej vitit 2012 për implementimin dhe vënien në funksion të sistemit Eterna me të gjitha modulet e tij sipas kërkesave nga vet Posta Shqiptare SHA. Konkretisht, ndërfaqet e sistemeve të pagesave me institucione të tjera, kanë ekzistuar edhe më parë (e vërtetuar kjo me komunikimet elektronike të Postës me operatorin ekonomik për problemet dhe defektet e ndryshme të ndodhura gjatë kalimit të kredive të fermerëve apo pagesave të ndryshme). Këto ndërfaqe kanë ekzistuar me OSHEE, me UKT, etj. Pra pretendimi i krijimit të një “GATEWAY”, nuk qëndron. Gjithashtu, tek DST e procedurës së prokurimit të vitit 2012, procedurë për të cilën është shpallur fitues i njëjti operator ekonomik “H. S.” SHPK, tek projekti për implementimin e sistemit ETERNA, për informatizimin e Postës Shqiptare, konstatohet se projekti ka ndërfaqe me sisteme të tjera, ndërfaqe me Bankën e Shqipërisë, ndërfaqe me sistemin IPS, ndërfaqe me sistemin Euro/Giro/non SWIFT. I njëjti konkluzion rezulton edhe nga auditimi i dosjes së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e sistemit Eterna” sipas kontratës së lidhur midis Postës Shqiptare SHA dhe po të njëjtit operator ekonomik “H.S.” SHPK, në vitin 2017, me afat 3 vjeçar pra deri në fillim të vitit 2020. Nga procesverbalet e mbajtura të grupit të monitorimit për mirëmbajtjen mujore 3 vjeçare, konstatohet se ky operator ka kryer mirëmbajtjen e sistemit (Deri sot. Kontrata e mirëmbajtjes përfundon në vitin 2020) dhe njëkohësisht të preventivit të zërave të mirëmbajtjes ku midis të tjerash ka mirëmbajtur sistemin Eterna financiare edhe lidhur me Listën e Moduleve të Eternës Financiare për tu mirëmbajtur. Periudha e mirëmbajtjes 2017-2020. Si rrjedhojë, procedura e prokurimit, ka qenë e pa argumentuar lidhur me arsyet dhe nevojat e kryerjes, pa asnjë analizë për rritjen e rezultateve ekonomike të parashikuara me plane financiare e strategjike apo edhe pas implementimit pa asnjë përfitim për PSH SHA. Ka qenë e pa nevojshme për Postën Shqiptare kjo procedurë sepse PSH SHA, i ka pasur ndërfaqet e komunikimit (GATEWAY) me institucionet e tjera dhe për më tepër, nuk ka asnjë marrëveshje me asnjë bankë përpara fillimit të procedurës ku të bëhej i qartë përfitimi monetar i PSH SHA nga komisionet e transaksioneve me bankat për çdo shumë të depozituar në llogarinë personale të klientit në bankën përkatëse. Gjithashtu, nga data që shërbimi është deklaruar i kryer pra nga data 19.12.2018 deri në muajin Maj 2019 (sipas akteve të marrjes në dorëzim), Posta Shqiptare SHA, nuk ka asnjë të ardhur apo përfitim nga ky shërbim. Nuk është kryer asnjë depozitim nga ndonjë klient i mundshëm, transaksion nga i cili, Posta Shqiptare SHA mund të kishte përfituar ndonjë komision gjithmonë nëse do të ekzistonte ndonjë marrëveshje. Vlera e investuar prej **30,000,000 lekë, konsiderohet investim me efekt negativ financiar për PSH SHA** dhe një dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen dhe që do të duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik përfitues “H. S.” SHPK, nëse sistemi nuk do të zbatohet me efektivitet duke i sjellë të ardhura financiare Postës Shqiptare (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Postës Shqiptare SHA, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masat që të lidhin marrëveshje me bankat duke përcaktuar komisionet përkatëse për shërbimin sipas kushteve të kontratës, me qëllim kthimin e investimit në një investim me efektivitet për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Posta Shqiptare sha kryhen pagesa për telefoninë celulare për punonjësit referuar faturave sipas paketave të lidhura për çdo numër të A. A. sha referuar kontratës së lidhur, ku për një pjesë të tyre bëhet rimbursimi nga fondet e Postës Shqiptare sha.

Rimbursimi i fondeve për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar në zbatim të vendimeve të drejtorisë së shoqërisë me nr.293, datë 25.04.2014 “Mbi ndryshimin e shpenzimeve të telefonisë celulare të Shoqërisë Posta Shqiptare sha ,vendimit nr.44, datë 7.02.2017 “Mbi disa ndryshime në vendimin nr.293, datë 25.04.2014 të Drejtorisë së Shoqërisë, si dhe Urdhrin e dalë për periudhën objekt auditimi me nr.193, datë 19.03.2018” Për miratimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për ndryshimet e miratuara në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare sha.

Për vendimet sa më sipër u krye krahasimi referuar përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 23.07.2010” Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik dhe nga ky krahasim ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi janë miratuar kryerja e shpenzimeve në kundërshtim me aktin në fuqi respektivisht sipas viteve: për 6 mujorin e dytë të 2017 shuma prej 571,560 lekë, për vitin 2018 shuma 1,256,400 lekë dhe për 5 mujorin e vitit 2019 shuma prej 1,318,560 lekë **në total 3,146,520 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa për të analizuar shkaqet, arsytet për përgjegjësitë e menaxhimit në drejtim të përdorimit të fondeve të shoqërisë jo me efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën prej 3,146,520 lekë, vlerë e cila ka të bëjë pagesat e telefonisë celulare të planifikuar për rimbursim në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sponsorizimeve është konstatuar se nga Posta Shqiptare janë dhënë sponsorizim në shumën 1,255,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar, nenin 1 dhe 2, ku ndalohet dhënia e sponsorizimit personave fizik sa më poshtë vijon:

-Për sponsorizimin e A. N. “Botimi i librit Historia e Filatelistëve Shqiptarë” në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës 2, datë 1.03.2019 në shumën 400,000 lekë.

-Për sponsorizimin A. M. për projektin “80 vjet transmetime radiofonike në shqip” në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 1.03.2019 në shumën 655,000 lekë.

-Për sponsorizimin M. G. për katalogun filatelik “Pulla Shqiptare” në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës 2, datë 1.03.2019 në shumën 200,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 91-94 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Administratori dhe Këshilli i Mbikëqyrës të merren masa për të analizuar shkaqet, arsytet për përgjegjësitë e menaxhimit në përdorimin e fondeve të shoqërisë në shumën 1,255,000 lekë jo me efektivitet dhe ekonomikitet, vlerë e cila ka të bëjë pagesat e dhëna për sponsorizim në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Me urdhër prokurimi nr. 6 datë 10.05.2018 ka filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Shërbimi e-learning”. Nga verifikimi i dokumentacionit të gjeneruar nga sistemi lidhur me zbatimin e kontratës nr. 6/1 datë 16.05.2018, u konstatua se numri i kursantëve të cilët ndoqën kursin e gjuhës së huaj ishte 132 ndërkohë që shërbimi është prokuruar për 140 punonjës, si dhe nga verifikimi i raporteve përfundimtare rezultojë se vetëm 15% e kursantëve kishin punuar me këtë program dhe mesatarja javore e përdorimit të programit nga punonjësit ishte 1 minutë në javë, çka tregon se implementimi i projektit me vlerën **408,000lekë** nuk ka arritur dhe përmbushur qëllimin ose nuk është kryer me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 90-94 të Raportit të Auditimit).

5.1Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të shqyrtohet shpenzimi jo eficient me vlerë **408,000 lekë** dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të verifikohet dhe të kërkohet menjëherë informacion për ecurinë e programit “e-learning” dhe e programeve të tjera me natyrë të ngjashme në kuadër të zhvillimit dhe trajnimit të punonjësve të shoqërisë Posta Shqiptare sha.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga Auditimi: Punonjësit e larguar nga puna në shoqërinë Posta Shqiptare sha, kanë hapur 193 procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 76 vendime të formës së prerë në vitet 2017-2019 me vlerë të efektit negativ financiar në shumën **60,037,836 lekë**. Ndërkohë, janë ende 74 procedura në proces gjyqësor të cilat janë potencial i mundshëm në të ardhmen për efekt negativ financiar për shoqërinë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 56-64 të Raportit të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare sha dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimi i detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë, si dhe të merren masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën totale **60,037,836 lekë**, të ardhur si pasojë e mos ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna. Të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore.

Menjëherë

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i vendimmarrjes së organeve kolegjiale të shoqërisë për periudhën objekt auditimi rezultojë se:

Për vitin 2018, me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32 datë 21.11.2018 është miratuar dhënia e shpërblimit të punonjësve të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Nga auditimi i relacionit bashkëlidhur vendimit rezultoi se ky shpërblim është dhënë *referuar pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018* në një kohë ku viti ushtrimor nuk kishte përfunduar ende *veprim në kundërshtim me Ligji nr. 10405 datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", neni 6*. Për pasojë, vendimmarrja për shpërblimet e punonjësve në vitin 2018 nuk mund ti referohet këtij argumenti. Gjithashtu, për dhënien e shpërblimit të punonjësve në vlerën **48,629,000 lekë** nuk është marrë miratimi nga Ministria përkatëse, Ministria e Financave dhe Ekonomisë referuar kompetencave ligjore që ajo ka (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 50-54 të Raportit të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Nga Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori të merren masat që në të ardhmen për praktika të ngjashme të ndiqet hierarkia ligjore e vendimmarrjes, duke marrë miratimin e Ministrisë përkatëse, Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe marrja e shpërblimit për treguesit ekonomiko-financiar të realizohet pas miratimit të pasqyrave financiare, konform kërkesave ligjore.

Menjëherë

8. Gjetje nga Auditimi: Me urdhër pagese datë 10.01.2018 është likuiduar fatura nr. 30 datë 11.09.2017 për OE "A. T. T." shpk me vlerë 127,680 lekë për blerjen e "dy bileta udhëtimi". Por në datën 15.09.2017 me vendim nr. 316, ky udhëtim është anuluar për të tre përfaqësuesit e shoqërisë duke sjellë si pasojë kryerjen e një shpenzimi jo eficient dhe efektiv për shoqërinë në vlerën **127,680 lekë** pasi biletat ishin prerë nga operatori para vendimit të anulimit dhe ishin të pakthyeshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 65-71 të Raportit të Auditimit*).

8.1 Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë të merren masat që në të ardhmen mos të përsëriten raste të ngjashme anulimi për personat e autorizuar për udhëtime jashtë vendit në mënyrë të tillë që çdo shpenzim i kryer në kuadër të atij aktiviteti të kryhet me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Referuar konstatimeve në këtë raport, mbështetur në nenin 15, pika "dh" dhe "e" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Kontratën individuale të punës të

hartuar dhe miratuar nga Posta Shqiptare SHA, neni 10 i rekomandojmë Administratorit që referuar analizës së shkeljeve të paraqitura në këtë Raport Auditimi dhe përgjegjësive të paraqitura për çdo shkelje përkatëse, të fillojë procedurat për marrjen e masave disiplinore për punonjësit sa më poshtë vijon:

Nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me “paralajmërim” për:

1. znj. M. H, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Marketingut, për arsye se:

-Për kontratën me objekt “Fushatë publicitare në median e shkruar online, dixhitale, median e shtypur dhe median në ambientet e jashtme”, viti 2017, nuk ka argumentuar nevojën e kryerjes së këtij shërbimi. Nuk ka kryer asnjë analizë tek e cila të pasqyroheshin në mënyrë të detajuar, përfitimet ekonomike që do të kishte Posta Shqiptare duke kryer këtë investim, detyra këto që i ka të përcaktuara tek rregullorja e brendshme e institucionit.

Ne cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore vitet 2018-2019

-Programim jo të saktë dhe të argumentuar mirë për zbatimin e numrit mesatar të punonjësve dhe fondit të pagave gjatë hartimit të Programit Ekonomik të vitit 2018.

-Nga procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të ndjekur, as të kritereve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj në zbatim të detyrave të pozicionit referuar *Rregullores nr. 6 datë 20.02.2018*.

-Nga auditimi i procedurës së blerjes me vlerë të vogël për shërbimin “E-learning” u konstatua se njësia e prokurimit ka kualifikuar si fitues OE pa dokumentacionin e plotë të kërkuar në kundërshtim me pikën 16, *Udhëzimin nr. 3 data 08.01.2018* "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". (në cilësinë e Kryetares së njësies së prokurimit).

Gjithashtu nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk është ndjekur zbatimi i programit “E-learning” mbi trajnimin e punonjësve (i iniciuar vetë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore) duke sjellë si pasojë që implementimi mos të funksionojë dhe të jetë kryer me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

në cilësinë e kryetares të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël

Pasi komisioni i prokurimit për blerjet me vlerë të vogël ka bërë s’kualifikimin të operatorit “A. C.” me ofertën ekonomike 747,000 lekë pa TVSH dhe 896,400 lekë me TVSH e cila është më e ulët se oferta fituese 943,034 lekë me TVSH, referuar kjo procedurave të përcaktuara në *VKM nr. 354., datë 11.05.2016* “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, dhe rekomandimin e APP duke shkaktuar dëm ekonomik 46,634 lekë me TVSH që rezulton nga llogaritja e diferencës midis vlerës së ofertës fituese me vlerën e operatorit të s’kualifikuar padrejtësisht (Më hollësisht trajtuar në pikën 3,5,6 të Raportit të Auditimit).

2. z. E. M, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Marketingut, për arsye se:

-Për kontratën me objekt “Fushatë publicitare në median vizive” dhe kontratën me objekt “Fushatë publicitare në median online”, viti 2018, nuk ka argumentuar nevojën e kryerjes së këtij shërbimi. Nuk ka kryer asnjë analizë tek e cila të pasqyroheshin në mënyrë të detajuar, përfitimet ekonomike që do të kishte Posta Shqiptare duke kryer këtë investim, detyra këto që i ka të përcaktuara tek rregullorja e brendshme e institucionit (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 52-64 të Raportit të Auditimit).

3. znj. A. Z;

4. znj. B. K;

Në cilësinë e anëtarëve të grupit të ndjekjes dhe ekzekutimit të kontratës për arsye se:

-Për kontratën me objekt “Fushatë publicitare në median vizive” viti 2018, nuk kanë monitoruar siç duhet afatet e ekzekutimit të kontratës duke përcaktuar në procesverbalin e mbajtur për përfundimin e kontratës se kontrata ka përfunduar brenda afateve ligjore kur në fakt, ajo është ekzekutuar jashtë afateve të përcaktuara e si rezultat, nuk janë mbajtur penalitetet(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

5. znj. E. V;

a) Në cilësinë e anëtares së grupit të ndjekjes dhe ekzekutimit të kontratës për arsye se:

-Për kontratën me objekt “Fushatë publicitare në median vizive” viti 2018, nuk ka monitoruar siç duhet afatet e ekzekutimit të kontratës duke përcaktuar në procesverbalin e mbajtur për përfundimin e kontratës se kontrata ka përfunduar brenda afateve ligjore kur në fakt, ajo është ekzekutuar jashtë afateve të përcaktuara e si rezultat, nuk janë mbajtur penalitetet.

b) Në cilësinë e anëtares së grupit të përlllogaritjes së fondit limit për arsye se:

-Në përlllogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt “Fushatë publicitare në median vizive” dhe “Fushatë publicitare në median online”, për vitin 2018, nuk i janë referuar vlerës së kontratës së mëparshme të vitit 2018 me të njëjtin objekt, duke e rritur atë me pasoja negative financiare për institucionin(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

6. znj. M.S;

7. z. H. B;

Në cilësinë e anëtarëve të grupit të përlllogaritjes së fondit limit për arsye se:

-Në përlllogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt “Fushatë publicitare në median vizive” dhe “Fushatë publicitare në median online”, për vitin 2018, nuk i janë referuar vlerës së kontratës së mëparshme të vitit 2018 me të njëjtin objekt, duke e rritur atë me pasoja negative financiare për institucionin (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit*).

8. znj.E.B. në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Për mosmbajtje të penaliteteve referuar nenit 12.1 të kontratës nr.10/1 datë 31.07.2018 “ Blerje instalim i pajisjes mbi sistemin e menaxhimit të radhës”. të lidhur me *kontraktonin ATOM shpk*. në shumën **104,140 lekë**, të cilat janë kamat vonesa për shërbim të vonuar

-Për likuidim më tepër për kontratën e furnizimit me karburant me E.D. A Sha në shumën 370,413 lekë si rezultat të aplikimit të kontraktonit në çmimin e faturës edhe të taksës së markimit apo shënimit ku referuar përcaktimeve të paraqitura në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, është një shpenzim dhe detyrim i operatorit.

-Për lejimin e dhënies së paradhënies për udhëtimet jashtë vendit, pa mbyllur paradhëniet paraardhëse në kundërshtim me udhëzimin *me pikën 66 të udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar*.

-Për përgjegjësitë referuar funksionit si Nëpunëse Zbatuese në drejtim të mbylljes me vonesë të pasqyrave financiare për vitin 2017 dhe 2018.

-Për përgjegjësitë referuar funksionit si Nëpunëse Zbatuese në mos mbylljen në kohë të procedurave për inventarizimin e aseteve të shoqërisë si dhe mbylljes me shumë vonesë të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

-Për përgjegjësitë referuar funksionit si Nëpunëse Zbatuese se për procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarit të vitit 2017 në vlerën 11,743,229.7 lekë për Drejtorinë e Përgjithshme nga Posta Shqiptare nuk ka njoftim për organet tatimore në zbatim të nenit 21 pika m të ligjit nr.8438, datë 28.12.2003 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe

Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 i ndryshuar pika 3.6.s., duke krijuar riskun që për vitin 2018 kur janë kryer veprimet e nxjerrjes nga përdorimi dhe kontabiliteti, këto shpenzime të mos njihen si shpenzime për efekte tatimore.

në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël

Pasikomisioni i prokurimit për blerjet me vlerë të vogël ka bërë s'kualifikimin të operatorit "A. C." me ofertën ekonomike 747,000 lekë pa TVSH dhe 896,400 lekë me TVSH e cila është më e ulët se oferta fituese 943,034 lekë me TVSH, referuar kjo procedurave të përcaktuara në VKM 354., datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, dhe rekomandimin e APP duke shkaktuar dëm ekonomik 46,634 lekë me TVSH që rezulton nga llogaritja e diferencës midis vlerës së ofertës fituese me vlerën e operatorit të s'kualifikuar padrejtësisht (Më hollësisht trajtuar në pikën 6,7 faqe 65-113 të Raportit të Auditimit).

9.znj. Sh. L. referuar detyrës funksionale si përgjegjëse e kontabilitetit pasi:

-Nga Drejtoria e Postës Shqiptare sha nuk janë hartuar në mënyrë të Veçantë pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2018 për aparatën e drejtorisë . Veprimet sa më sipër bien në kundërshtim me nenin 158 pika 3 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, bien në kundërshtim me nenin 18 " Përgjegjësitë" ,të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar në të cilin citohet: "1. Organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi i tij mbikëqyrës, të punësuar ose jo, janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kërkesave, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji.

2. Ekspertimi ligjor i pasqyrave financiare nga ekspertë të pavarur të licencuar nuk e çliron organin e drejtimit ekzekutiv dhe atë mbikëqyrës të njësisë ekonomike nga përgjegjësitë, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni."

Si dhe nenin 12 " Përbërësit e pasqyrave financiare" ku citohet:" Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente: a) bilancin kontabël; b) pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve; c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta; ç) pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash flow); d) anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.

-Për përgjegjësitë referuar funksionit si përgjegjëse e kontabilitetit në drejtim të mbylljes me vonesë të pasqyrave financiare për vitin 2017 dhe 2018 (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 100-113 të Raportit të Auditimit).

10.znj. J. N.

në cilësinë e anëtares të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël

Pasi komisioni i prokurimit për blerjet me vlerë të vogël ka bërë s'kualifikimin të operatorit "A. C." me ofertën ekonomike 747,000 lekë pa TVSH dhe 896,400 lekë me TVSH e cila është më e ulët se oferta fituese 943,034 lekë me TVSH, referuar kjo procedurave të përcaktuara në VKM 354., datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, dhe rekomandimin e APP duke shkaktuar dëm ekonomik 46,634 lekë me TVSH që rezulton nga llogaritja e diferencës midis vlerës së ofertës fituese me vlerën e operatorit të s'kualifikuar padrejtësisht (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 25-50 të Raportit të Auditimit).

PËR PUNONJËSITË LARGUAR.

Për z. P. N, me detyrë ish Drejtor i Filialit Shkodër nuk propozojmë masë pasi ky punonjës është i larguar. Masa e propozuar do të ishte "Vërejtje me shkrim" pasi në Filialin Shkodër,

gjatë vitit 2018, struktura e programuar ishte tejkaluar me një numër mesatar prej 3 punonjës duke rezultuar dhe me një tejkalim të shpenzimeve për paga në vlerën 963,000 lekë për këtë filial.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R